



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

## Fjalimi përshëndetës i Guvernatorit

Tetor 31, 2023

---

**Ngjarja:** Dita Botërore e Kursimeve

**Organizator:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

**Koha dhe vendi:** 31 tetor 2023 ora 11:00, BQK

---

I nderuari, z. Jaha, Drejtor i Gjimnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë

E nderuara, znj. Shatri, Mësimdhënëse

Nxënës të dashur,

Ju drejtohem sot në Ditën Botërore të Kursimeve, e cila ka për qëllim që të promovoj shprehitë edukative duke promovuar kulturën e kursimeve në botë, veçanërisht në Republikën e Kosovës.

Dita Botërore e Kursimeve u vendos të shënohet si ngjarje për të promovuar kursimet, më 31 tetor 1924 në Kongresin e Parë Botëror të Bankës së Kursimeve, i cili u mbajt në Milano të Italisë. Kjo ditë shënohet me aktivitete informuese e edukative me qëllim të informimit e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e përgjegjësinë financiare të kursimeve dhe ndikimin e tyre në të ardhmen.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës këtë ditë për të 8-tin vit me radhë e shënon përmes aktiviteteve të vetëdijësimit, edukative e informuese me qëllim të nxitjes së nxënësve dhe të rinjve për t'u informuar e kuptuar aftësinë e menaxhimit të duhur të parave.

Komisioni Evropian vitin 2024 e ka shpallur Viti i Aftësive dhe natyrisht përfshihen edhe aftësitë e edukimit financiar, si njëra ndër aftësitë kryesore sociale, menaxhimi i financave personale, në mënyrë që vendimet e qytetarëve pastaj të jenë vendime të duhura për të ardhmen.

Edhe BQK-ja do ta ketë në fokus qasjen në financa dhe gjithëpërfshirjen si dhe edukimin financiar, ku do të punojë gjatë viti 2024 në këtë drejtim. Për këtë qëllim do të bashkërendohemi edhe me Bankën e Shqipërisë, që të bashkëpunojmë dhe harmonizojmë materialet e edukimit financiar dhe propozojmë të jenë pjesë e plan programeve shkollore, për aq sa është e mundur.

Bota po ndryshon shpejt e ne duhet të jemi në hap me të, ndryshimet e avancuara të teknologjisë informative, ndryshime mjedisore e sociale, e ndryshime gjeopolitike, janë bërë pjesë e përditshmërisë tonë, e ne duhet të përgatitemi të përballemi me to. Sot më shumë se kurrë është e rëndësishme e nevojshme që të kultivojmë një kulturë të mirëfilltë të menaxhimit e mbrojtjes së financave personale dhe mbrojtjes së ambientit, në mënyrë që në aspektin social e mjedisor si individ, si familje apo si shoqëri të kemi stabilitet e qëndrueshmëri.

Ju jeni ende të ri, por është koha e duhur të mendoni për të ardhmen tuaj financiare, dhe rol të rëndësishëm ka krijimi i njohurive e aftësive të menaxhimit të duhur të financave personale, krijimi i shprehisë se kursimeve dhe ndërgjegjësimi mbi çështjet ekonomike e financiare.

Të rinjtë duhet t'i vendosin vetës qëllime të qarta financiare dhe për t'i arritur këto, duhet të filloni sa me herët të punoni për arritjen e tyre. Unë dhe BQK-ja ju inkurajojmë që të përgatiteni për gjërat që do t'ju vijnë në të ardhmen. Informohuni e mësoni rreth çështjeve ekonomike e financiare, nga materialet të cilat janë në faqen zyrtare të BQK-së për Edukimin Financiar [edukimifinanciar.org](http://edukimifinanciar.org), apo edhe në rrjetet sociale të BQK-së, ku mund të informoheni rreth shumë temave e çështjeve, të cilat do t'ju ndihmojnë për të ardhmen e juaj.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të zgjerojë bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe me institucione tjera relevante në mënyrë që të sigurojë edhe më shumë materiale edukative, të cilat do të shpërndahen në institucionet arsimore, ku ju të keni mundësi të mësoni e informoheni rreth këtyre temave.

Për fund, dëshiroj t'ju informoj që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, duke pas parasysh nxitjen e të rinjve që të mësojnë e informohen sa më shumë rreth rëndësisë së kursimeve, sot shpall Konkurs për nxënësit e klasave X-XII të shkollave të arsimit të mesëm të lartë të Republikës së Kosovës, të realizojnë punime apo ese, mbi konceptin e tyre për kursimet.

Konkursi do të jetë i hapur një muaj dhe pas mbylljes komisioni përzgjedhës do t'i vlerësojë dhe do t'i përzgjedhë 10-të nga punimet më të mira, të cilat do të shpërblehen edhe financiarisht.

BQK-ja u inkurajon juve dhe të gjithë nxënësit e shkollave të mesme që të konkurroni me punimet tuaja dhe gjithashtu ta ndani këtë informatë edhe me nxënës të tjerë, qoftë në shkollën apo me shoqërinë tuaj.

Disa këshilla:

- Kontrolloni shpenzimet;
- Bëni një plan-buxhet;
- Shpenzoni në mënyrë racionale;
- Blini gjërat që ju duhen;
- Bëhuni të vet qëndrueshëm;
- Përcaktoni qëllimet dhe planet për kursime; dhe
- Kursimi i parave është dhurata më e bukur që mund t'ia bëni vetës.

Ju faleminderit dhe suksese!